



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 23 janar 2023
Nr. ref.:MK 2115/23

MENDIM KONKURRUES

i gjyqtarit

RADOMIR LABAN

në rastin nr. KI143/22

Parashtrues

Hidroenergji SH.P.K.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
ARJ. UZVP. nr. 51/2022 të 19 korrikut 2022**

Duke shprehur që në fillim respektin dhe pajtimin tim me mendimin e shumicës së gjyqtarëve se në këtë rast ka shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), unë si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese konsideroj se ka edhe një shkelje tjetër e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë e kryer ndaj parashtruesit të kërkesës dhe që i referohet shkeljes së të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, të cilën do të përpiqem ta arsyetoj më poshtë.

Unë si gjyqtar pajtohem me gjendjen faktike siç është deklaruar dhe paraqitur në Aktgjykim dhe e pranoj të njëjtën gjendje faktike si të saktë. Gjithashtu, pajtohem me mënyrën se si janë parashtruar dhe paraqitur pretendimet e parashtruesit të kërkesës në Aktgjykim.

Për sa më sipër, dhe në pajtim me rregullat 62 dhe 63 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, mendimin tim konkurrues do ta paraqes me shkrim. Për të ndjekur sa më lehtë dhe më qartë arsyetimin e mendimit tim konkurrues, unë **(I)** do të përsëris pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; **(II)** do të vlerësoj aplikueshmërinë e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; **(III)** do të paraqes përmbajtjen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; **(IV)** do të arsyetoj parimet themelore të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; **(V)** do të zbatoj parimet

themelore të cekura më lart në rastin konkret; (VI) do të paraqes një përfundim në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

(I) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

1. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmes të cilit është shtyrë ekzekutimi i vendimeve për dhënien e lejeve ujore dhe mjedisore që i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë së tij për prodhim të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në mënyrë të drejtpërdrejtë ka cenuar të drejtën e tij në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të drejtës së tij në pronë i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), përkatësisht rasteve Tre Traktor AB kundër Suedisë; Pressos Compania Naviera SA et al kundër Belgjikës; Capital Bank AD kundër Bullgarisë; Lönnroth kundër Suedisë dhe Saliba kundër Maltës.
2. Parashtruesi i kërkesës pretendon se duke pasur parasysh të gjitha aktet juridike dhe normat imperative, fundamentale që ato përmbajnë në lidhje me të drejtën në pronë e sidomos “përcaktimin e Kushtetutës në lidhje me këtë të drejtë-shihet qartë se-e drejta në pronë është e drejtë fundamentale dhe e pacenueshme e njeriut”, marrë për bazë faktin që kjo e drejtë hyn në Kapitullin II të Kushtetutës për të Drejtat dhe Liritë Themelore.
3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Duke pasur për bazë jurisprudencën e GJEDNJ-së-nëpërmjet Nenit 53 të Kushtetutës-duhet pasur parasysh se koncepti i pronësisë është shume gjerë i interpretuar. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së ky koncept nuk përfshin vetëm pronën dhe të drejtën mbi të-në kuptim material dhe klasik të fjalës, por përfshinë një gamë të gjerë të të drejtave monetare-të drejta që rrjedhin nga, ndër të tjera, licencat e po ashtu edhe të drejtat që rrjedhin nga drejtimi i një biznesi [...] Madje, duke shkuar edhe më larg, në Pressos Compania Naviera SA et al [kundër Belgjikës], GJEDNJ përfundoi se edhe një kërkesë për kompensim mund të konsiderohet si aset - ne kuptim të pasurisë dhe gëzon mbrojtje sipas Nenit 1, të Protokollit 1, të KEDNJ-së kur provohet mjaftueshëm nga pala se ekziston pritja legjitime që një kërkesë e tillë mund të realizohet”.*
4. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, pajisja me licencë përbën pritje legjitime që ai do të zhvillojë veprimtarinë e tij në mënyrë të papenguar për shkak se ai i ka plotësuar kushtet ligjore në çastin kur është pajisur me licencë, prandaj, pritja legjitime e parashtruesit të kërkesës gëzon mbrojtje nga neni 46 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
5. Sipas parashtruesit të kërkesës: *“Leja Ujore dhe Leja Mjedisore që janë dhënë parashtruesit të kërkesës nga ana e MMPHI, dhe pajisja me Licence të prodhimit nga ZRRE, janë esenciale për aktivitetin e kësaj kompanie, ngase në momentin e zbatimit të një vendimi gjyqësor siq është vendimi për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të kontestuara si masë e përkohshme, me të cilën ndalohen plotësisht operimi mbi bazën e atyre lejeve, kompania është e detyruar të ndalojë në tërësi veprimtarinë e saj deri në vendosjen meritorë të çështjes nga gjykata”. Në lidhje me këtë ai pretendon se: “Marr parasysh mbingarkesën e gjykatave në fjale, dhe praktikave në rastet tjera, një vendim meritor për çështjen në fjale mund të merret pas më shume se (3-4) vite, edhe përkundër*

se besojmë se e drejta do të mbizotërojë në rastin e parashtruesit, pasi që nga fillimi i ndërtimit, finalizimit, pranimit teknik, komisionimit ambiental, dhe fillimit të operimit janë respektuar të gjitha kushtet dhe obligimet e dhëna me ligj dhe nga institucionet përgjegjëse jemi pajisur me lejet dhe Licencën për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e renovueshme, dhe çdo kohe e pezullim do të jetë në shkelje të të drejtave të parashtruesit të kërkesës”.

6. Në mbështetje të pretendimit si më lart, parashtruesi i kërkesës specifikon se: *“Për të vërtetuar edhe më tej që i shkaktohet padrejtësisht [atij] mjafton vetëm të shikohet prodhimi i energjisë elektrike, nga burimet e ripertëritshme për vitin 2019-2021 nga ana e këtij të fundit. Sipas Raporteve të KOSTT, energjia elektrike e prodhuar dhe lëshuar në rrjet për konsum nga konsumatorët e Kosovës (energji e pastër), nga ana e Parashtruesit të kërkesës për vitin 2019 nga muaji qershor është 5,134, 000 kWh energji elektrike nga 191,700,000 kWh të prodhuar nga burimet e renovueshme në Kosovë. Poashu në vitin 2020 parashtruesi i kërkesës ka prodhuar 28,159,000 kWh energji të pastër elektrike, ndërsa në vitin 2021 ka prodhuar 25,124,000 kWh energji të pastër elektrike. Këto të dhëna dëshmojnë se parashtruesi i kërkesës me pamundësinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i respektuar edhe prurjet biologjike sipas Lejes Ujore, do t'i shkaktohet dëm jashtëzakonisht i madh, dhe për pasoj dëmtim edhe jo-material”.*
7. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Përveç se dëmi është i madh në kuptim monetar, i njëjti është edhe i pariparueshëm. Kjo ngase, ashtu siç dihet në strukturat e financimit dhe instrumentet financiare për financimin e projekteve kapitale të tilla investuese është jashtëzakonisht e komplikuar, e posaçërisht kur merret për bazë se një pjesë e madhe e investimit është financuar nga bankat Komerciale në Kosove me kredi hipotekare, përmes hipotekave kreditore. Në rast se nuk fillohet me kthimin e mjeteve të investuara për një periudhë që nga muaji i parë i pezullimit e deri në tre (3) vite kjo do të rezultonte në pamundësinë financiare për të mbijetuar për Kompaninë e me këtë edhe do të rrezikohet kthimi i kredive me c’ rast bankat do të fillojnë me realizimin e kërkesave të tyre përmes procedurave përmbaruese me c’ rast do të shiten edhe pasurit (shtëpitë ku jetojmë) të lëna me hipotekë – Hidroenergji do të kanosej seriozisht në likuidim”.*
8. Në vijim, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe parimit të pritjes legjitime, për të cilin thekson se: *“ [dispozitat e nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së] nuk mund t’ia dobësoj të drejtën shtetit për të sjell ligje që vlerësohen si të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e tatimit ose kontributeve tjera dhe gjobave”. Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës duke iu referuar rastit Lonroth kundër Suedisë thekson se: “GJEDNJ-ja ka vendosur tri (3) parime bazë, që aplikohen sa i përket intervenimit/kufizimit të së drejtës në pronë sipas Nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-se, dhe ato janë si në vijim: i) Parimi i ligjshmërisë;(ii) parimi i ekzistimit të qëllimit legjitim në mbrojtjen e interesit publik dhe (iii) parimi i një baraspeshe të drejt në mes të mbrojtjes se interesit publik dhe të drejtës në pronë të personit të caktuar proporcionaliteti”.*
9. Parashtruesi i kërkesës specifikon se ndërhyrja në të drejtën e pronës mund të justifikohet vetëm *“nëse është e mbështetur me ligj [i referohet rastit të GJEDNJ-së Saliba kundër Maltës]; është e mbështetur në një qëllim legjitim e që është në interes publik ose të përgjithshëm dhe kufizimi i kësaj të drejte duhet të jetë i bazuar në parimin e proporcionalitetit, përkatësisht - të mos privohet askush po që së ndërmjet mjeteve dhe masave tjera (të lehta) mund të arrihet mbrojtja e interesit të përgjithshëm”.*
10. Duke iu referuar rastit të GJEDNJ-së, Capital Bank AD kundër Bullgarisë, parashtruesi i kërkesës shton se: *“GJEDNJ në rastin Capital Bank AD kundër Bullgarisë, ka gjetur*

se kriteri i ligjshmërisë, supozon, ndër të tjera që ligji vendor duhet të ofroj mekanizëm për mbrojtje kundër ndërhyrjeve arbitrare nga ana e autoriteteve publike. Më tutje, Gjykata thekson se “koncepti i ligjshmërisë dhe i sundimit të ligjit në shoqëri demokratike kërkon që masat të cilat afektojnë të drejtat e njeriut, të mund të jenë objekt shqyrtimi para organeve të pavarura gjyqësore”. Andaj, sipas GJEDNJ-së, “çdo ndërhyrje në gëzimin paqësor të pronës duhet të përcjellët me garanci procedurale që i mundësojnë individëve apo subjekteve juridike që të prezantojnë rastin e tyre para autoriteteve përgjegjëse në mënyrë që të sfidojnë seriozisht hapat me të cilat është ndërhyrë në të drejtat e garantuara sipas kësaj dispozite”.

11. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur nenin 119 (4) [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës që obligon Republikën e Kosovës që të promovojë mirëqenie dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm sepse: “Marrë parasysh kapacitetet energjetike ekzistuese të Republikës së Kosovës, dhe faktin se përveç mungesës së theksuar të kapaciteteve prodhuese, edhe kriza globale energjetike, dhe rritja enorme e çmimeve të importit, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Nenin 119, paragrafi 4, pasi që ky Aktgjykim dekuron zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik”.
12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se duke pasur parasysh zbatimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe mungesën e arsytimit bindës të Gjykatës Supreme, nuk ka pasur garanci të mjaftueshme ndaj arbitraritetit të Gjykatës Supreme çka ka rezultuar me shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

(II) Vlerësimi i aplikueshmërisë së nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

13. Fillimisht do të vlerësoj nëse leja ujore dhe ajo mjedisore përbëjnë “pronë” brenda kuptimit të këtyre dispozitave, për të konstatuar nëse neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së janë të aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, përkatësisht nëse pretendimet e ngritura të parashtruesi i kërkesës për shkelje të këtyre dispozitave janë *ratione materiae* në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, ashtu siç përcaktohet me rregullin 39 (3) të Rregullores së punës së Gjykatës.
14. Rikujtoj se objekt i vlerësimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës është pezullimi apo shtyrja e ekzekutimit të dy vendimeve për lëshimin e Lejes Ujore, të 5 qershorit 2021 dhe Lejes Mjedisore të 26 qershorit 2021. Po ashtu rikujtoj se parashtruesi i kërkesës posedon edhe Licencën për prodhimin e energjisë, të lëshuar nga ZREE, megjithatë paditësit/propozuesit nuk kishin kërkuar pezullimin e kësaj licence, dhe si e tillë kjo nuk përbën objekt të vlerësimit të kërkesës së tanishme. Megjithatë, theksoj se veprimtaria biznesore e parashtruesit të kërkesës për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtitshme nuk mund të realizohet pa lejen ujore dhe mjedisore. Për pasojë, vërej se Leja Ujore dhe Leja Mjedisore janë të domosdoshme për vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë biznesore të parashtruesit të kërkesës.
15. Për të konstatuar nëse Leja Ujore dhe ajo Mjedisore përbëjnë pronë në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, i referohem praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.
16. GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore në parim ka theksuar se koncepti i pronës në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së ka një kuptim autonom i cili nuk është i kufizuar në posedimin e të mirave materiale dhe është i pavarur nga klasifikimi formal nga ana e legjislacionit vendor. Në këtë kuptim, GJEDNJ ka theksuar se duhet të përcaktohet që në rrethanat e rastit konkret, të shikuara në tërësinë e tij, parashtruesit të kërkesës i kanë akorduar një titull me interes përmbajtësor të garantuar më këtë

dispozitë (shih *Brosset-Triboulet dhe të Tjerët kundër Francës* [DHM] nr. 34078/02, Aktgjykim, i 29 marsit 2010, paragrafi 65).

17. Në lidhje me veprimtarinë biznesore që i nënshtrohet kërkesës së një leje apo licence, Gjykata në rastin *Malik kundër Mbretërisë së Bashkuar* (kërkesa nr. 23780/08, Aktgjykim i 13 marsit 2012) ka arsyetuar:

“91. Në rastet kur lëshimi i licencave apo lejeve për ushtrimin e një aktiviteti biznesor, GJEDNJ ka theksuar se revokimi ose heqja e asaj leje apo licence paraqet ndërhyrje në të drejtën e parashtruesit për gëzim paqësorë të pronës, përfshirë edhe interesin ekonomik që ndërlidhet me biznesin (shih *Fredin kundër Suedisë* (Nr. 1), [nr. 12033/86, Aktgjykim i 18 shkurtit 1991, paragrafi 40] në lidhje me lejen e shfrytëzimit për një gropë zhavorri dhe mutatis mutandis *Tre Traktörer AB kundër Suedisë* [nr. 10873/84, Aktgjykim i 7 korrikut 1989] në lidhje me licencën për shërbimin e pijeve alkoolike në një restorant. Shih, gjithashtu, *Rosenzweig dhe Bonded Warehouses Ltd. kundër Polonisë* [i 30 nëntorit 2005, kërkesa nr. 51728/99, paragrafi 49] në lidhje me licencën për të drejtuar një magazinë për mallra të importuara). Në këtë kuptim Gjykata [GJEDNJ] në mënyrë specifike në rastin *Tre Traktörer AB* vërejtë se vazhdimi i licencës ishte një nga kriteret apo kërkesat parësore për ushtrimin e veprimtarisë biznesore të parashtruesit të kërkesës, dhe se revokimi i saj kishte efekt të pafavorshëm në mirëbesimin dhe vlerën e restorantit (shih paragrafët 43 dhe 53 të Aktgjykimit të Gjykatës).

[...]

94. ...[në] rastet që përfshijnë **pezullimin apo revokimin** e një licence apo leje ose refuzimi që një person të përfshihet në listën e individëve për ushtrimin e një profesioni specifik, Gjykata ka tentuar që konsiderojë si “pronë” biznesin themelor apo ushtrimin e profesionit në fjalë. Kufizimet e bëra ndaj regjistrimit, licencës apo lejeve që ndërlidhen me punën që ushtrohet përmes biznesit apo profesionit nga Gjykata shikohen në përgjithësi si mjete përmes të cilave ka ndodhur ndërhyrja në një biznes po ushtrimi të profesionit.”

18. Marrë për bazë faktin që në rrethanat e rastit konkret, Leja Ujore dhe ajo Mjedisore nuk janë revokuar por janë pezulluar, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse edhe pezullimi i një leje të tillë përbën “pronë”, gjegjësisht nëse neni 46 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është i aplikueshëm në rrethanat e parashtruesit të kërkesës. Gjykata në këtë rast i referohet edhe praktikës përkatëse gjyqësore të GJEDNJ-së që ndërlidhet me rrethanat kur shfrytëzimi i një leje ose licence është pezulluar apo ndaluar përkohësisht.

19. Në lidhje me këtë të fundit, vërej se GJEDNJ në rastin *O'Sullivan McCarthy Mussel Development Ltd kundër Irlandës* (nr. 44460/16, Aktgjykim i 8 tetorit 2018) kishte konstatuar se licenca për mbledhjen e midhjeve dhe midhjeve të reja, e lidhur me aktivitetin parësor të biznesit të akuakulturës së parashtruesit të kërkesës, u konsiderua “pronë” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në këtë rast, GJEDNJ kishte theksuar:

“88. Në përputhje me sa më sipër, Gjykata vlerëson se rasti konkret ka të bëjë me një “pronë”, përkatësisht biznesin bazë të akuakulturës së kompanisë parashtruese. Është e vërtetë, siç theksoi Qeveria, se të gjitha licencat dhe autorizimet e ndryshme që kishte kompania parashtruese ruajtën vlefshmërinë e tyre në vitin 2008. Në këtë drejtim, rasti ndryshon nga rastet e vendosura më parë nga Gjykata, të cilat përfshinin anulimin ose revokimin të një licence ose lejeje, duke i dhënë fund një aktiviteti tregtar (shih, ndër shumë të tjera, *Tre Traktörer AB*, të cituar më lart, ku licenca e kompanisë parashtruese për të shërbyer pije alkoolike u tërhoq duke çuar në mbylljen e ndërmarrjes menjëherë më pas; shih gjithashtu *Vékony kundër Hungarisë*, nr.

65681/13, paragrafi 29, 13 janar 2015, që përfshin anulimin ligjor të licencës së parashtruesit për të shitur duhan, e pasuar menjëherë me mbylljen e biznesit të tij). Megjithatë, Gjykata vëren se ka gjetur gjithashtu se neni 1 i Protokollit Nr. 1 zbatohet edhe kur licenca në fjalë në fakt nuk ishte tërhequr, por konsiderohej se ngeli pa thelb (Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano kundër Italisë [GC], nr. 38433/09, paragrafët 177-178, GJEDNJ 2012).

89. Duke qenë të vetëdijshëm për nevojën për të parë përtej dukjes dhe për të hetuar realitetet e situatës për të cilën ankohet në rastin konkret, Gjykata konsideron se ndalimi i përkohshëm i peshkimit të farës së midhjes që u zbatua gjatë periudhave në fjalë në vitin 2008 duhet të konsiderohet me të drejtë si një kufizim i vendosur ndaj një leje – autorizimi i farës së midhjes që i është dhënë për vitin 2008 – lidhur me ushtrimin e zakonshëm të biznesit të vet.

90. Për Gjykatën, faktet e rastit zbulojnë kështu një ndërhyrje nga autoritetet vendore në të drejtën e kompanisë parashtruese për gëzimin paqësor të pronës së saj, duke përfshirë interesat ekonomike që lidhen me biznesin bazë. Megjithatë, fakti që ndërhyrja e kundërshtuar konsistonte në një ndalim të përkohshëm të një pjese të aktiviteteve të kompanisë parashtruese sipas licencës ose lejes, që autorizimi nuk ishte tërhequr ose revokuar, dhe se në çdo rast autorizimi në bazë të të cilit kompania parashtruese ushtronte biznesin u nënshtrohej kushteve, të gjitha do të jenë pjesë e analizës së Gjykatës për natyrën dhe shtrirjen e asaj ndërhyrjeje. Është brenda këtij konteksti të kufizuar dhe të veçantë që analiza e Gjykatës duhet kuptuar (shih, mutatis mutandis, Malik, cituar më lart, paragrafi 95 dhe më poshtë).

91. Nga kjo rrjedh se kjo ankesë nuk është e papajtueshme ratione materiae me nenin 1 të Protokollit Nr. 1.”

20. Bazuar në parimet e lartcekura, vërej se në rrethanat e rastit konkret leja ujore dhe leja mjedisore përbëjnë “pronë” për shkak se ndërlidhen me ushtrimin e aktivitetit biznesor të parashtruesit të kërkesës për shfrytëzimin e Hidrocentralit në lumin Lepenc për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Në rrethanat e rastit konkret, leja mjedisore dhe ajo ujore janë pezulluar me pasojën që edhe aktiviteti i tij parësor për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme është pezulluar deri në marrjen e një vendimi në merita nga gjykatat e rregullta.
21. Duke i aplikuar konstatimet e lartcekura në rrethanat e rastit konkret, unë konsideroj se:
 - (i) leja ujore dhe ajo mjedisore përbëjnë pronë në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së;
 - (ii) pezullimi i lejes mjedisore dhe asaj ujore ka rezultuar në kufizimin e përkohshëm për një kohë të pacaktuar të ushtrimit të veprimtarisë biznesore të parashtruesit të kërkesës; dhe
 - (iii) ky kufizim mund të rezultojë me ndërhyrje në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës së parashtruesit të kërkesës, duke përfshirë edhe interesat ekonomike që ndërlidhen me biznesin bazë.
22. Rrjedhimisht, konstatoj se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, në të cilat rrethana procedura ndërlidhet me pezullimin e këtyre dy lejeve deri në nxjerrjen e një vendimi gjyqësor në merita, neni 46 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është i aplikueshëm.

(III) Përmbajtja e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

23. Në këtë kuptim, fillimisht rikujtoj përmbajtjen e nenit 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

1. *"E drejta e pronës është e garantuar.*
2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet".*

[...]

Neni 1 (Mbrotjtja e Pronës) i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së:

1. *Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveç se për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*
2. *Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.*

(IV) Parimet themelore të nenit 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

24. Përmbajtja e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe zbatimi i tij, janë interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikës gjyqësore të saj, të cilës, ashtu siç është theksuar më lart, do t'i referohem në lidhje me interpretimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
25. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 46 të Kushtetutës, fillimisht vlerësoj se e drejta e pronës nga paragrafi 1 i nenit 46 të Kushtetutës garanton të drejtën e posedimit të pronës; paragrafi 2 i nenit 46 të Kushtetutës përcakton mënyrën e shfrytëzimit të pronës, duke specifikuar qartë se shfrytëzimi i saj rregullohet me ligj dhe në pajtim me interesin publik; dhe, paragrafi 3, garanton që askush nuk mund të privohet nga prona në mënyrë arbitrare, duke përcaktuar gjithashtu kushtet nën të cilat prona mund të shpronësohet (shih rastin e Gjykatës, KI50/16, parashtrues Veli Berisha dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 marsit 2017; KI67/16, parashtruese Lumturiye Voca, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2016).
26. Rikujtoj se na bazë të paragrafit 2 të nenit 46 të Kushtetutës, e drejta në pronë mund të kufizohet me ligj. Në këtë rast, konsideroj se Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të rregullojë me ligj shfrytëzimin e pronës, në përputhje me interesin publik.
27. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, vërej se GJEDNJ ka konstatuar se e drejta pronësore përbëhet nga tri rregulla të ndryshme. Rregulli i parë, i cili përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë dhe i cili ka natyrë të përgjithshme, formulon parimin e gëzimit paqësor të pronës. Rregulli i dytë, në fjalinë e dytë të të njëjtit paragraf përfshin privimin nga prona dhe ia nënshtron atë kushteve të caktuara. Rregulli i tretë, i cili përfshihet në paragrafin e dytë të këtij neni ua njeh shteteve, ndërmjet të tjerash, të drejtën për të kontrolluar

shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, me zbatimin e atyre ligjeve që ato i konsiderojnë të nevojshme për këtë qëllim (shih rastin e GJEDNJ-së, Spórrong dhe Lönnrot kundër Suedisë, nr. 7151/75, 7152/75, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, paragrafi 61; dhe rastin e Gjykatës, KI86/18, parashtuese Slavica Đorđević, Aktgjykim i 3 shkurtit 2021, paragrafi 140).

28. Megjithatë, të gjitha rregullat e mësipërme nuk janë "të ndryshme" në kuptimin që nuk janë të ndërlidhura me njëra tjetrën. Rregulli i dytë dhe ai i tretë i referohen rasteve të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës dhe duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të shprehur në rregullin e parë (shih rastet e GJEDNJ-së Bruncrona kundër Finlandës, të 16 shkurtit 2005, kërkesa nr. 41673/98, paragrafi 65; Anheuser-Busch Inc kundër Portugalisë, Aktgjykim i 11 janarit 2007, kërkesa 73049/01 paragrafi 62; James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8793/79, Aktgjykim i 21 shkurtit 1986, paragrafi 37, Beyeler kundër Italisë, nr. 33202/96, Aktgjykim i 5 janarit 2020, paragrafi 98, dhe shih rastin e Gjykatës KI129/16, parashtues "KOSBAU GmbH", Aktvendim për papranueshmëri i 13 nëntorit 2017, paragrafi 35).
29. Dispozitat e mësipërme, megjithatë, nuk do të zvogëlojnë në asnjë mënyrë të drejtën e shtetit për të zbatuar ligje të tilla që ai i konsideron të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave ose kontributeve të tjera ose dënimeve (shih rastin e GJEDNJ-së, Ish-Mbreti i Greqisë dhe të tjerët kundër Greqisë, nr. 25701/94, Aktgjykim i 23 nëntorit 2000, paragrafi 50).
30. Megjithatë, ndërhyrja duhet të plotësojë disa kushte: ajo duhet të jetë në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe të ndjekë një qëllim legjitim në një mënyrë që është në proporcion të arsyeshëm me qëllimin që kërkohet të arrihet (shih rastin e GJEDNJ-së, Beyeler kundër Italisë, cituar më lart, paragrafët 108- 114).
31. Kjo qasje përfaqëson strukturën e metodës që Gjykata përdor për të shqyrtuar rastet kur bindet se neni 46 i Kushtetutës dhe 1 i Protokollit nr. 1 janë të aplikueshëm. Ajo përbëhet nga një sërë hapash të njëpasnjëshëm në të cilat zgjidhen pyetjet në vijim: A ka pasur ndonjë ndërhyrje në të drejtën e parashtuesit të kërkesës në gëzimin paqësor të "pronës" së tij? Nëse po, a përbën kjo ndërhyrje privim nga pronësia? Nëse jo, a është fjala për kontrollin e shfrytëzimit të pronësisë? Nëse masat që ndikuan në të drejtat e parashtuesit të kërkesës nuk mund të konsiderohen as privim dhe as kontroll të shfrytëzimit të pronësisë, Gjykata interpreton gjendjen faktike të rastit në dritën e rregullit të përgjithshëm të respektimit të gëzimit paqësor të "pronës".

(V) Zbatimi i parimeve themelore të cekura më lart në rastin konkret

32. Për të shqyrtuar pretendimet e parashtuesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duhet së pari të zbatohet një test i cili përbëhet nga 4 (katër) hapa, përkatësisht duhet të përcaktohet: **(1)** nëse ka pasur pengesa ose ndërhyrje në gëzimin paqësor të pronës dhe cili lloj i ndërhyrjes ekziston në rastin konkret; **(2)** nëse pengesa ose ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës është përcaktuar me ligj; **(3)** nëse pengesa ose ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës ka pasur një qëllim legjitim; dhe **(4)** nëse pengesa apo ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës ishte proporcionale, përkatësisht e përpjesëhme.

(1) Nëse ka pasur pengesa ose ndërhyrje në gëzimin paqësor të pronës dhe cili lloj i ndërhyrjes ekziston në rastin konkret

33. Vërej se parashtguesit të kërkesës i ishin lëshuar lejet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit të tij biznesor dhe atë përmes vendimeve të Ministrisë përkatëse për Mjedis, gjegjësisht përmes Vendimit të 5 qershorit 2020 për lëshimin e Lejes Ujore për një periudhë njëzet (20) vjeçare dhe Vendimit të 26 qershorit 2020 për lëshimin e Lejes Mjedisore për një periudhë pesë (5) vjeçare. Në vijim të kësaj, ZRRE po ashtu i kishte lëshuar parashtguesit të kërkesës edhe Licencën për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme. Megjithatë, rikujtoj se kjo licencë nuk ishte objekt i propozimit të paditësve/propozuesve për shtyrje të ekzekutimit të saj në procedurën e ndjekur para gjykatave të rregullta.
34. Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësit/propozuesit, më 30 dhjetor 2021, kishin paraqitur në Gjykatën Themelore padi administrative për anulimin e vendimeve të Ministrisë përgjegjëse për lëshimin e lejes ujore dhe mjedisore. Gjithashtu, rikujtoj se paditësit/propozuesit kishin paraqitur edhe propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të këtyre dy vendimeve deri në nxjerrjen e një aktgjykimi në merita.
35. Në lidhje me kronologjinë procedurale të zhvilluar para gjykatave të rregullta, ashtu siç është elaboruar edhe më lart, rikujtoj se vendimi i fundit i nxjerrë në procedurë sipas propozimit për shtyrje të ekzekutimit të dy vendimeve të Ministrisë përgjegjëse është Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përmes të cilit ishte refuzuar revizioni i parashtguesit të kërkesës dhe ishte vërtetuar qëndrimi dhe konstatimi i dhënë përmes aktvendimeve të Gjykatës Themelore dhe të Apelit.
36. Bazuar në atë si më lart, rezulton që parashtguesit të kërkesës i është pezulluar ose shtyrë ekzekutimi i lejes ujore dhe mjedisore, të lëshuara nga një autoritet publik për një periudhë të pacaktuar, dhe i cili pezullim në mënyrë të drejtpërdrejtë ka afektuar ushtrimin e aktivitetit të tij biznesor.
37. E përsëris se në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së, përveç marrjes ose heqjes së licencave të vlefshme të biznesit, po ashtu edhe revokimi i përkohshëm apo pezullimi përbejnë ndërhyrje në të drejtën për gëzim paqësor të pronës, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1. Sipas GJEDNJ-së, kjo ndërhyrje përbën një masë kontrolli të shfrytëzimit të pronës, e cila shqyrtohet sipas paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (shih mutatis mutandis rastin e GJEDNJ-së O'Sullivan McCarthy Mussel Development Ltd kundër Irlandës, të cituar më lart, paragrafi 104).
38. Prandaj, bazuar në të lartcekurat, konsideroj se përmes vendimit përfundimtar të nxjerrë në këtë procedurë, gjegjësisht Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, pezullimi apo shtyrja e ekzekutimit të dy vendimeve të lartcekura për lëshimin e Lejes Ujore dhe asaj Mjedisore për një afat të pacaktuar ka rezultuar në ndërhyrje në të drejtën e parashtguesit të kërkesës për gëzim paqësor të pronës, përkatësisht, kontrollimin e shfrytëzimit të pronës së parashtguesit të kërkesës, dhe për pasojë atij menjëherë i është pamundësuar ushtrimi i veprimtarisë së tij biznesore dhe është penguar të ushtrojë veprimtarinë e tij biznesore për të cilën ka pasur leje të vlefshme.
39. Megjithatë, rikujtoj se pavarësisht konstatimit të lartcekur se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka rezultuar në ndërhyrjen e gëzimit paqësor të pronës nga ana e parashtguesit të kërkesës, kjo e fundit bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së duhet në vijim të vazhdojë me shqyrtimin e çështjes nëse ndërhyrja ka qenë e paraparë me ligj (shih rastin e GJEDNJ-së, Megadat.com SRL kundër Moldavisë, cituar më lart, paragrafi 66).

(2) Nëse pengesa ose ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës është përcaktuar me ligj

40. Për të kryer këtë hap të testit, përkatësisht për të përcaktuar nëse pengesa ose ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës ishte përcaktuar me ligj, fillimisht do të përshkruaj **(a)** parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së të treguara në praktikën gjyqësore në lidhje me shprehjen “e paraparë me ligj” (“prescribed by law”) dhe më pas do të kryej **(b)** zbatimin e parimeve të përgjithshme të parapara me ligj (“prescribed by law”).

(a) Parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së të paraqitura në praktikën gjyqësore lidhur me shprehjen “e paraparë me ligj” (“prescribed by law”)

41. Çdo ndërhyrje në të drejtat e mbrojtura me nenin 1 të Protokollit nr. 1 duhet të jetë në pajtim me prezumimin e ligjshmërisë (shih rastet e GJEDNJ-së Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë, nr. 71243/01, Aktgjykim i 25 tetorit 2012, paragrafi 95; Béláné Nagy kundër Hungarisë, nr. 53080/13, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2016, paragrafi 112). Shprehja “në kushtet e parapara me ligj” që i referohet çdo ndërhyrjeje në të drejtën për gëzimin paqësor të “pronës” duhet të interpretohet në të njëjtën mënyrë si shprehja “në pajtim me ligj” nga neni 8 i KEDNJ-së në raport me të drejtat e mbrojtura nga ajo dispozitë ose termi “e paraparë me ligj” që i referohet ndërhyrjes në të drejtat e mbrojtura sipas neneve 9, 10 dhe 11 të KEDNJ-së.
42. Parimi i ligjshmërisë është kërkesa e parë dhe më e rëndësishme nga neni 1 i Protokollit nr. 1. Fjala e dytë e paragrafit të parë e lejon ndërhyrjen në “pronë” vetëm “në kushtet e parapara me ligj”, dhe paragrafi i dytë u njeh shteteve të drejtën të kontrollojnë përdorimin e pronës duke zbatuar “ligjet”. Përveç kësaj, sundimi i ligjit, një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, është pjesë e të gjitha neneve të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së, Iatridis kundër Greqisë, Aktgjykim i 25 marsit 1999, nr. 31107/96, paragrafi 58; Ish-Mbreti i Greqisë dhe të tjerët kundër Greqisë, cituar më lart, paragrafi 79; dhe Broniowski kundër Polonisë, nr. 31443/96, Aktgjykim i 22 qershorit 2004, paragrafi 147).
43. Ekzistenca e një baze ligjore në të drejtën e brendshme nuk mjafton në vetvete për të përmbushur parimin e ligjshmërisë. Përveç kësaj, baza ligjore duhet të ketë një cilësi të caktuar, domethënë të jetë në përputhje me sundimin e ligjit dhe të ofrojë garanci kundër arbitraritetit. Në lidhje me këtë, duhet theksuar se kur flitet për “ligjin”, neni 1 i Protokollit nr. 1 aludon për të njëjtin koncept të cilit KEDNJ i referohet në nene të tjerë kur përdor atë shprehje, një koncept që përfshin ligjet dhe praktikën gjyqësore (shih rastet e GJEDNJ-së, Špaček, s.r.o. kundër Republikës Çeke, nr. 26449/95, Aktgjykim i 9 nëntorit 1999, paragrafi 54; Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë, cituar më lart, paragrafi 96).
44. Parimi i ligjshmërisë nënkupton gjithashtu se dispozitat e zbatueshme të ligjit të brendshëm janë mjaftueshëm të qasshme, të sakta dhe të parashikueshme në zbatimin e tyre (shih rastet e GJEDNJ-së, Beyeler kundër Italisë, cituar më lart, paragrafi 109; Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 60642/08, Aktgjykim i 16 korrikut 2016, paragrafi 103; Centro Europa 7 S.R.L. dhe DI Stefano kundër Italisë, cituar më lart, paragrafi 187).
45. Në lidhje me disponueshmërinë, termi “e drejtë” duhet të interpretohet në kuptimin e tij material, jo në kuptimin e tij formal. Prandaj, fakti që disa rregulla të caktuara që kanë të bëjnë me ushtrimin e të drejtave të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit nr. 1 nuk janë publikuar në gazetata zyrtare në formën e parashikuar me ligjin për miratimin e instrumenteve legjislative ose rregullatore që detyrojnë qytetarët dhe personat juridikë në përgjithësi, nuk pengon që këto rregullore të konsiderohen e drejtë, nëse Gjykata është e bindur se publiku është i vetëdijshëm për to në një mënyrë tjetër (shih rastin e GJEDNJ-së, Špaček, s.r.o., kundër Republikës Çeke, cituar më lart, paragrafët 57-60).

46. Më tej, Gjykata rikujton se kur shqyrtohen në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1, ligjet me zbatim retrospektiv për të cilët u konstatua se përfaqësojnë ndërhyrje legislative ishin megjithatë në përputhje me kërkesën e ligjshmërisë nga neni 1 i Protokollit nr. 1 (shih rastet e GJEDNJ-së, Maggio dhe të tjerët kundër Italisë, nr. 46286/09, 52851/08, 53727/08, 54486/08 dhe 56001/08, Aktgjykim i 31 gushtit 2011, paragrafi 60; Arras dhe të tjerët kundër Italisë, nr. 17972/07, Aktgjykim i 14 majit 2012, paragrafi 81).
47. Përdorimi i masave të kontrollit të zbatuara në bazë të ligjeve të nxjerra pas shfaqjes së fakteve që çojnë deri te ndërhyrja, si të tilla, nuk janë të paligjshme (shih rastin e GJEDNJ-së, Saliba kundër Maltës, nr. 4251/02, Aktgjykim i 8 shkurtit 2006, paragrafët 39-40) nëse ato ligje nuk janë miratuar në veçanti për të ndikuar në rezultatin e një rasti individual. As Konventa dhe as protokollat e saj nuk parandalojnë ndërhyrjen e legjislativitetit në kontratat ekzistuese me efekt prapaveprues (shih rastin e GJEDNJ-së, Mellacher dhe të tjerët kundër Austrisë, nr. 10522/83, 11011/84, 11070/84, Aktgjykim i 19 dhjetorit 1989; paragrafi 50; Bäck kundër Finlandës, nr. 37598/97, Aktgjykim i 20 tetorit 2004, paragrafi 68).
48. Megjithatë, në rrethana të caktuara, zbatimi retrospektiv i legjislacionit që ka efektin e privimit të një personi nga "prona" ekzistuese e cila ishte pjesë e "pronësisë" së tij mund të përbëjë një ndërhyrje që mund të prishë ekuilibrin e drejtë midis kërkesave me interes të përgjithshëm nga njëra anë dhe mbrojtjes së gëzimit paqësor të së drejtës së "pronësisë" nga ana tjetër (shih rastin e GJEDNJ-së, Maurice kundër Francës, nr. 11810/03, Aktgjykim i 6 tetorit 2005, paragrafët 90 dhe 93).
49. Parimi i ligjshmërisë përfshin gjithashtu detyrën e shtetit ose autoritetit tjetër publik për të respektuar urdhrat e gjykatës ose vendimet e marra kundër tij (shih rastin e GJEDNJ-së, Belvedere Alberghiera S.r.l. kundër Italisë, nr. 31524/96, Aktgjykim i 30 tetorit 2000, paragrafi 56).
50. Në fund, në rastin Aliyeva dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit, GJEDNJ gjithashtu konkludoi se kur vendimet qartazi kontradiktore, dhe veçanërisht vendimet e Gjykatës Supreme, ku janë nxjerrë aktgjykimet që përmbanin vlerësime kontradiktore për të njëjtën situatë në rastet e parashtruesve të kërkesës dhe në rastet e iniciuara nga persona të tjerë, përfaqësojnë ndërhyrje në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës, nëse nuk jepet shpjegim i arsyeshëm për dallimet, ndërhyrjet e tilla nuk mund të konsiderohen të ligjshme për qëllimet e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës sepse çojnë në mospërputhje të procedurave të tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, Aliyeva dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit, nr. 66249/16 66271/16 75978/16 77309/16 77691/16 1038/17 52821/17, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2021, paragrafët 130-135).

(b) Zbatimi i parimeve të përgjithshme "të parapara me ligj" ("prescribed by law")

51. Duke iu kthyer rastit konkret, vërej se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përmes të cilit janë vërtetuar edhe aktvendimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit është i bazuar në kriteret e përcaktuar me nenin 22 të LKA-së.
52. Bazuar në atë si më sipër, konkludoj se ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës së parashtruesit të kërkesës është shkaktuar me vendimet e gjykatave të rregullta, përkatësisht Gjykatës Supreme, bazuar në ligjin e aplikueshëm, përkatësisht Ligjin nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe i cili ka qenë në fuqi në momentin e marrjes së vendimit.

53. Ashtu siç është cekur më lart, konsideroj se parimi i ligjshmërisë nënkupton gjithashtu se dispozitat e zbatueshme të ligjit të brendshëm janë të qasshme, të sakta dhe të parashikueshme në zbatimin e tyre, në rastin konkret, kemi të bëjmë me një ligj të votuar në një seancë publike të Kuvendit, i cili është publikuar në Gazetën Zyrtare dhe Gjykata arrin në përfundimin se ligji ishte në dispozicion të parashtruesit të kërkesës dhe se normat ishin të sakta dhe të parashikueshme.
54. Përdorimi i masave të kontrollit të zbatuara në bazë të ligjeve të nxjerra pas shfaqjes së fakteve që çojnë deri te ndërhyrja, si të tilla, nuk janë të paligjshme (shih rastin e GJEDNJ-së, Saliba kundër Maltës, nr. 4251/02, Aktgjykim i 8 shkurtit 2006, paragrafët 39-40) nëse ato ligje nuk janë miratuar në veçanti për të ndikuar në rezultatin e një rasti individual. Në rastin konkret, vërej se ligji i kontestuar ka efekt të përgjithshëm dhe nuk synon të ndikojë në rastin individual të parashtruesit të kërkesës, por ka vepruar erga omnes dhe ka synuar të rregullojë rregullat e procedurës administrative në tërësi.
55. Prandaj, Gjykata konstaton se masat për kontrollin e përdorimit të pronës, përkatësisht masat për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve për nxjerrjen e Lejes Ujore dhe asaj Mjedisore për një afat të pacaktuar janë bazuar në nenet 6 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Gjithashtu, është e qartë se nenet 6 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative ishin përgjithësisht të zbatueshme, se ato ishin të vlefshme dhe ligjërish të aplikueshme, se të njëjtat ishin në dispozicion dhe të parashikueshme për parashtruesin e kërkesës.
56. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se ndërhyrja në të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gëzimin paqësor të pronës është e “përcaktuar me ligj”.

(3) Nëse ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës ka ndjekur një qëllim legjitim (interesin publik)

57. Sipas GJEDNJ-së, çdo ndërhyrje në gëzimin e të drejtave dhe lirive të njohura nga Konventa duhet të ketë një qëllim legjitim. Po kështu, në rastet që përfshijnë një detyrë pozitive, duhet të ketë një justifikim legjitim për mosveprimin e shtetit. Vetë parimi i “ekuilibrit të drejtë” i qenësishëm për nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, presupozon ekzistencën e një interesi të përgjithshëm të komunitetit. Për më tepër, duhet përsëritur se rregullat e ndryshme të përfshira në nenin 1 nuk janë të dallueshme, në kuptimin e moskoherencës, dhe se rregulli i dytë dhe i tretë u referohen vetëm rasteve të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës. Një nga efektet e kësaj është se ekzistenca e “interesit publik” e përcaktuar në fjalinë e dytë, ose “interesit të përgjithshëm” në paragrafin e dytë, në fakt janë pasojë e parimit të përcaktuar në fjalinë e parë, kështu që ndërhyrja në ushtrimin e të drejtës për gëzimin paqësor të pronës në kuptimin e fjalisë së parë të nenit 1 duhet të ketë gjithashtu një qëllim në interesin publik (shih, rastet e GJEDNJ-së, Broniowski kundër Polonisë, cituar më lart, paragrafi 148; Könyv-Tár Kft dhe të tjerët kundër Hungarisë, nr. 21623/13, Aktgjykim i 16 marsit 2018, paragrafi 45; Beyeler kundër Italisë, cituar më lart, paragrafi 111).
58. Lista e qëllimeve për të cilat ndërhyrja do të binte në sferën e konceptit të interesit publik është e gjerë dhe mund të përfshijë qëllime të ndryshme të reja që i nënshtrohen shqyrtimeve të politikës publike në kontekste të ndryshme faktike. Konkretisht, vendimi për të miratuar një ligj, sipas të cilit konfiskohet prona ose kompensimi nga sigurimi social zakonisht përfshin shqyrtimin e çështjeve politike, shoqërore dhe sociale (shih rastet e GJEDNJ-së, Ish-Mbreti i Greqisë dhe të tjerët kundër Greqisë, cituar më lart, paragrafi 87; Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë, cituar më lart, paragrafi 106).
59. Nën sistemin e mbrojtjes që është themeluar nga Konventa, u mbetet autoriteteve nacionale që të bëjmë vlerësimin fillestar lidhur me ekzistimin e një problemi që përbën

brengë publike e për të cilin duhet ndërmarrë masa të privimit të pronës ose ndërhyrjes në gëzimin paqësor të “pronave”. Këtu, siç ndodhë në fushat tjera të cilat i mbron Konventa, autoritetet nacionale gëzojnë një marginë të gjerë të vlerësimit. Për shembull, margjina e vlerësimit që është në dispozicion të legjislaturës gjatë implementimit të politikave sociale dhe ekonomike do të jetë e gjerë dhe Gjykata do të respektojë gjykimin e legjislaturës nacionale lidhur me atë që është “në interes publik”, përveç nëse ai është në mënyrë evidente pa bazë të arsyeshme (shih rastin e GJEDNJ-së, Béláné Nagy kundër Hungarisë, cituar më lart, paragrafi 113).

60. Më tej, koncepti i “interesit publik” është domosdoshmërisht i gjerë (shih rastet e GJEDNJ-së, Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë, cituar më lart, paragrafi 106; R.Sz. kundër Hungarisë, nr. 41838/11, Aktgjykim i 4 nëntorit 2013, paragrafi 44; Grudić kundër Serbisë, nr. 31925/08, Aktgjykim i 24 shtatorit 2012, paragrafi 75). Gjykata zakonisht respekton pretendimet e shteteve se ndërhyrja që shqyrton ishte në interes publik dhe shqyrtimi i saj në këtë drejtim është i intensitetit më të ultë. Prandaj, pretendimi i parashtruesit të kërkesës se një masë e caktuar në realitet i shërbente një qëllimi të ndryshëm nga ai që ishte thirrur shteti i paditur në kontekstin e një rasti të veçantë në Gjykatë, rrallëherë ka një perspektivë serioze për sukses. Në çdo rast, është e mjaftueshme për Gjykatën që ndërhyrja të jetë në interesin publik, edhe nëse ky interes është i ndryshëm nga interesi i shprehur shprehimisht nga shteti në procedurën në Gjykatë. Madje, në disa raste, Gjykata e konstatoi qëllimin sipas detyrës zyrtare (Ambruosi kundër Italisë, nr. 31227/96, aktgjykim i 19 janarit 2001, paragrafi 28; Marija Božić kundër Kroacisë, 50636/09, aktgjykim i 24 prillit 2014, paragrafi 58).
61. Si rezultat i këtij respekti për vlerësimin e autoriteteve vendase, ka shembuj të rrallë të situatave në të cilat Gjykata nuk ka konstatuar se ka një interes publik që do të justifikonte ndërhyrjen (shih rastet e GJEDNJ-së, S.A. Dangeville kundër Francës, nr. 36677/97, Aktgjykim i 16 korrikut 2022, paragrafët 47 dhe 53 - 58 – moskthimi i taksës së parapaguar; Rosenzweig dhe Bonded Warehouses Ltd. kundër Polonisë, cituar më lart, paragrafi 56 - anulimi i licencës së biznesit të parashtruesit të kërkesës pa iu referuar ndonjë arsyeje me interes publik nga autoritetet në vendimet autoritative).
62. Duke iu rikthyer rrethanave të rastit konkret, vërej se Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 3129/2021] të 13 janarit 2021, arsyetoi se: “Paditësit-propozuesit ka[në] ofruar prova të besueshme të cilat vërtetojnë faktin se ekzekutimi i vendimit do t’i sillte dëm paditësit i cili dëm vështirë do të riparohej dhe se shtyrja e tillë nuk është në kundërshtim me interesat e publikut. Këtë vlerësim gjykata e ka mbështetur në faktin se paditësit-propozuesit e kanë argumentuar mjaftueshëm se duke u bazuar në dispozitat e lartcekura janë përmbushur kushtet ligjore që të aprovohet propozimi i paditësve-propozuesve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, deri sa gjykata të vendosë përfundimisht lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar përkitazi me padinë e paditësve konform dispozitave ligjore [paragrafët 5 dhe 6 të nenit 22 të LKA-së].”
63. Po ashtu, vërej se propozuesit/paditësit në padinë e tyre për anulim të dy vendimeve të Ministrisë përgjegjëse për Mjedis pretenduan, ndër të tjera, se Leja Mjedisore e 26 qershorit 2020 është lëshuar në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, dhe se Leja Ujore, e 5 qershorit 2020 është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjin për Ujërat e Kosovës si dhe ndërtimi i hidrocentralit ka shkaktuar dëme në mjedis, i cili ka rezultuar në mohimin e ujit të pijes dhe ujitjes për banorët. Përderisa në propozimin e tyre për shtyrje të vendimeve të Ministrisë, paditësit/propozuesit theksuan se: (i) ekzekutimi i dy vendimeve të kontestuara do t’i sillte dëm të pariparueshëm atyre dhe do të ishte në kundërshtim me interesin publik; dhe (ii) shtyrja e ekzekutimit të vendimeve të kontestuara nuk do t’i sillte dëm të madh parashtruesit të kërkesës.

64. Gjykata Supreme sërish kishte konstatuar se: “Poashtu, kjo gjykatë ka gjetur se ekzekutimi i vendimeve deri në nxjerrjen e vendimit meritator nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik dhe as shtyrja nuk do të sillte ndonjë humbje më të madhe palës kundërshtare, përkatësisht palës së interesuar. Ne këtë mënyrë do të shmangeshin pasojat e mundshme në të ardhmen në rast se do të vërtetohej se vendimet e kontestuar të paditurës, në fund të procesit gjyqësor do të rezultonin në kundërshtim me ligjin. Duhet po ashtu të theksohet që sipas mendimit të kësaj gjykate, shtyrja e ekzekutimit të vendimit të paditurës me asgjë nuk mund të prejudikohet, ngase bëhet fjalë për një vendim të përkohshëm, gjegjësisht i njëjti vlen deri në nxjerrjen e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sipas padisë së paditësit”.
65. Bazuar në sa më sipër, rikujtoj se Gjykata Supreme Aktgjykimin e saj e justifikoi me atë se pezullimi i këtyre dy lejeve ishte në interes publik dhe për pasojë kishte për qëllim shmangien e dëmit të pariparueshëm që mund t’iu shkaktonte paditësve/propozuesve, të cilët padinë dhe propozimin e tyre e kishin parashtruar në emër të qytetarëve.
66. Në vijim të lartcekurave, Gjykata i referohet edhe Aktgjykimit të GJEDNJ-së në rastin O’Sullivan McCarthy Mussel Development Ltd kundër Irlandës, përmes të cilit kishte theksuar se:

“109. Në lidhje me qëllimin e ndërhyrjes, është e qartë se qëllimi ka qenë mbrojtja e ambientit. Ashtu sikurse Gjykata [GJEDNJ] shumë shpesh ka theksuar, kjo është një konsideratë gjithnjë e më e rëndësishme në shoqërinë e sotme, duke u bërë një kauzë mbrojtja e të cilës ngjall interesin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të publikut, dhe rrjedhimisht autoritetet publike (shih për shembull Depalle, cituar më lart, paragrafi 81, po ashtu Matczyński, cituar më lart, paragrafi 101). Autoritetet publike marrin një përgjegjësi që në praktikë do të rezultojë në ndërhyrjen nga ana e tyre në kohën e duhur për të siguruar që dispozitat ligjore të miratuara me qëllim të mbrojtjes së mjedisit nuk janë krejtësisht të paefektshme (shih për shembull, S.C. Fiercolect Impex S.R.L. kundër Rumanisë, nr. 26429/07, paragrafi 65, 13 dhjetor 2016). Në vijim, në rastin konkret masat e vendosura u miratuan për të siguruar përputhjen e shtetit me detyrimet e tij të bazuara në ligjin e BE- së, të cilin Gjykata [GJEDNJ] gjithashtu e ka njohur si një objektiv legjitim të interesit të përgjithshëm me peshë të konsiderueshme (shih Bosphorus, cituar më lart, paragrafi 150; Lohuis dhe të tjerët kundër Holandës, nr. 37265/10, paragrafi 54, 30 prill 2013; Michaud kundër Francës, nr. 12323/11, paragrafi 100, GJEDNJ 2012; dhe Coopérative des agriculteurs de la Mayenne and Coopérative laitière Maine-Anjou kundër Francës (dec.), nr. 16931/04, GJEDNJ 2006-XV).”

67. Duke u bazuar në të lartcekurat, vërej se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj ka ndjekur një qëllim legjitim me arsyetimin se pezullimi ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik lidhur me dëmin e mundshëm të pariparueshëm që mund t’iu shkaktonte paditësve/propozuesve.

(4) Nëse pengesa ose ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës ka qenë proporcionale ose e përpjesshme

68. Për të qenë në pajtim me rregullin e përgjithshëm të përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1, ndërhyrja në të drejtën e gëzimit paqësor të “pronës”, përveç që duhet të jetë e paraparë në ligj dhe në interes publik, duhet të rezultojë me “ekuilibër të drejtë” mes kërkesave të interesit publik të komunitetit dhe kërkesave për të mbrojtur të drejtat themelore të individit (shih rastet e GJEDNJ-së, Beyeler kundër Italisë, cituar më lart, paragrafi 107; Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë dhe Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, cituar më lart, paragrafi 108).

69. Me fjalë tjera, në rastet që përfshijnë shkelje të pretenduara të nenit 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata duhet të vlerësojë nëse për arsye të veprimit apo mosveprimit të Shtetit personi në fjalë është dashur të bartë një barrë joproporcionale dhe të tepërt. Gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë kërkesë, Gjykata duhet të bëjë një shqyrtim të gjithëmbarshtëm të interesave të ndryshme në këtë çështje, duke pasur parasysh se Konventa ka për qëllim të mbrojë të drejtat të cilat janë “praktike dhe efektive”. Në këtë kontekst, duhet theksuar se pasiguria - qoftë legjislative, administrative apo që lind nga praktikat e aplikuara nga autoritetet, është faktor që merret parasysh gjatë vlerësimit të sjelljes së një Shteti (shih rastin e GJEDNJ-së, Broniowski kundër Polonisë, cituar më lart, paragrafi 151)
70. Kërkimi i këtij ekuilibri është i mishëruar në tërë Konventën dhe gjithashtu reflektohet në strukturën e nenit 1 të Protokollit nr. 1 (shih rastet e GJEDNJ-së, Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë, cituar më lart, paragrafi 69; Brumărescu kundër Rumanisë, nr. 28342/95, Aktgjykim i 28 tetorit 1999, paragrafi 78; Saliba kundër Maltës, cituar më lart, paragrafi 36).
71. Çështja nëse është gjetur ekuilibri i drejtë bëhet relevante vetëm pasi të jetë konstatuar se ndërhyrja në fjalë i ka shërbyer interesit publik, e ka plotësuar kërkesën e ligjshmërisë dhe nuk ka qenë arbitrare (shih rastet e GJEDNJ-së, Iatridis kundër Greqisë, cituar më lart, paragrafi 58; Beyeler kundër Italisë, cituar më lart, paragrafi 107).
72. Kjo çështje është më së shpeshti vendimtare për përcaktimin nëse ka pasur apo jo shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1. Gjykata zakonisht kryen një analizë të detajuar të kërkesës së proporcionalitetit, për dallim nga shqyrtimi shumë më i kufizuar i asaj nëse ndërhyrja ka ndodhur në interes publik.
73. Qëllimi i testit të proporcionalitetit është të vërtetojë së pari se si dhe deri në çfarë mase parashtruesit të kërkesës i është kufizuar ushtrimi i të drejtave të prekura nga ndërhyrja e ankimuar dhe cilat ishin pasojat negative të kufizimit të imponuar mbi ushtrimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës në situatën e tij. Pas kësaj, ky ndikim krahasohet me rëndësinë e interesit publik, për shkak të të cilit ka ardhur deri te ndërhyrja.
74. Gjatë këtij ekzaminimi, GJEDNJ merr parasysh faktorë të shumtë. Nuk ekziston një listë fikse e faktorëve në fjalë. Ata ndryshojnë nga rasti në rast, varësisht nga gjendja faktike e rastit dhe natyra e ndërhyrjes në fjalë. Faktorët dhe faktet që gjykata merr parasysh gjatë testit mund të jenë si në vijim: **a)** Faktorët proceduralë; **b)** Përzgjedhja e masave; **c)** Çështje substanciale relevante për testin e ekuilibrit të drejtë; **d)** Aspekte të ndërlidhura me parashtruesin e kërkesës; **e)** Kompensimi për ndërhyrje në pronësi si element; dhe **f)** Përfundimi në lidhje me ekuilibrin e drejtë.

a) Faktorët proceduralë

75. Edhe pse neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk përmban supozime shprehimore procedurale, i njëjti është interpretuar se nënkupton që individit të prekur nga ndërhyrja në gëzimin paqësor të “pronës” së tij duhet t’i ofrohet mundësi e arsyeshme që të paraqes argumentet e tij/saj para autoriteteve përgjegjëse me qëllim të kontestimit efektiv të masave në fjalë, duke pretenduar, varësisht prej rastit, se janë të paligjshme apo se përbëjnë sjellje arbitrare dhe të paarsyeshme (shih rastet e GJEDNJ-së, G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët kundër Italisë, nr. 1828/06, Aktgjykim i 28 qershorit 2018, paragrafi 302; AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 9118/80, Aktgjykim i 24 tetorit 1986, paragrafët 55 dhe 58-60).

76. Relevant është fakti nëse argumentet e rëndësishme të paraqitura nga parashtruesit e kërkesave ishin ekzaminuar me kujdes nga autoritetet (shih rastet e GJEDNJ-së, Megadat.com SRL kundër Moldavisë, cituar më lart, paragrafi 74; Bistović kundër Kroacisë, nr. 2577/05, Aktgjykim i 31 gushtit 2007, paragrafi 37).
77. Sa i përket faktorëve proceduralë, vërej se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësinë që ta kontestojë Aktvendimin e Gjykatës Themelore, fillimisht pranë Gjykatës së Apelit dhe më pas Gjykatës Supreme, ashtu që parashtruesi i kërkesës ka pasur një mundësi të arsyeshme për t'i paraqitur argumentet e tij para autoriteteve kompetente me qëllim të kontestimit efektiv të këtyre masave, duke pretenduar, në varësi të rastit, se ato janë të paligjshme ose se ato përbëjnë trajtim arbitrar dhe të paarsyeshëm (shih rastin e GJEDNJ-së, G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët kundër Italisë, cituar më lart, paragrafi 302).
78. Më tej vërej se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij në Gjykatë ngriti pretendime të detajuara në lidhje me: (i) zbatimin e gabuar që ndërlidhet me interpretimin dhe zbatimin e nenit 22 të LKA-së në rrethanat e rastit të tij; (ii) pretendimin për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, veçanërisht në procedurën e zhvilluar para Gjykatës Supreme; (iii) shkeljen e të drejtës së tij në pronë; dhe (iv) pretendimin për vendosjen e masës së përkohshme nga Gjykata kundër Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.
79. Rikujtoj se në lidhje me pretendimin e tij për zbatimin arbitrar të nenit 22 të LKA-së, Gjykata tashmë ka konstatuar se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme konsiston në shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për arsye se si mungesë e arsyetimit të pamjaftueshëm, i njëjti ka rezultuar në konkluzione arbitrare për parashtruesin e kërkesës.
80. Rrjedhimisht, konsideroj se për sa i përket faktorëve proceduralë, parashtruesi i kërkesës kishte një mundësi të arsyeshme për t'i paraqitur argumentet e tij para gjykatave të rregullta. Megjithatë, në procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta, e veçanërisht asaj para Gjykatës Supreme, këto të fundit nuk i kanë shqyrtuar me kujdes pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës.

b) Përzgjedhja e masave

81. Një nga elementet e testit të ekuilibrit të drejtë është çështja nëse kanë ekzistuar masa të tjera më pak ndërhyrëse që autoritetet publike mund t'i kishin zbatuar në mënyrë të arsyeshme në ndjekje të interesit publik. Megjithatë, ekzistimi i mundshëm i masave të tilla nuk e bën vetvetiu të pajustificueshëm legjislacionin e kontestuar. Me kusht që legjislatura të qëndrojë brenda kornizave të veta të margjinës së vlerësimit, nuk është në domenin e Gjykatës që të vlerësojë nëse legjislacioni ka përfaqësuar zgjidhjen më të mirë për të trajtuar problemin ose nëse diskrecioni i legjislaturës do duhej ushtruar në një mënyrë tjetër (shih rastin e GJEDNJ-së, James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, cituar më lart, paragrafi 51; Koufaki dhe Adedy kundër Greqisë, nr. 57657, Vendim i 7 majit 2013, paragrafi 48).
82. Mund të jetë gjithashtu relevante çështja nëse ka qenë e mundshme të arrihet i njëjti qëllim përmes masave më pak ndërhyrëse mbi të drejtat e parashtruesit të kërkesës dhe nëse autoritetet e kanë shqyrtuar mundësinë e aplikimit të këtyre zgjidhjeve më pak ndërhyrëse (shih rastet e GJEDNJ-së, OAO Neftyanaya Kompaniya Yukos kundër Rusisë, nr. 14902/12, Aktgjykim i 8 marsit 2012, paragrafët 651-654; Vaskrsić kundër Sllovenisë, nr. 31371/12, Aktgjykim i 25 korrikut 2017, paragrafi 83).

83. Në rastin para meje, konsideroj se ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës, përkatësisht masa e kontrollit të shfrytëzimit të pronës ka qenë një situatë momentale e cila ka kërkuar ndërprerjen e aktivitetit afarist të parashtruesit të kërkesës dhe se nuk ka pasur masa të tjera alternative, sepse pas vendimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të paditurve dhe pezullimin e ekzekutimit të licencave për një periudhë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës ka qenë i detyruar të ndërpresë me efekt të menjëhershëm veprimtarinë e tij ekonomike, duke u përballur me një barrë të rëndë dhe joproporcionale.
84. Prandaj, Gjykata konkludon se nuk ka pasur masa të tjera alternative, masa të tilla që janë më pak ndërhyrëse, të cilat autoritetet publike kanë mundur t'i zbatonin në mënyrë të arsyeshme në ndjekje të interesit publik. Gjykata konsideron se i njëjti qëllim mund të ishte arritur nga një ndërhyrje më pak invazive në të drejtat e parashtruesit të kërkesës, si dhe se autoritetet nuk shqyrtuan mundësinë e zbatimit të atyre zgjidhjeve më pak ndërhyrëse.

c) Çështje substanciale relevante për testin e ekuilibrit të drejtë

85. Në rastet e caktuara, testi i ekuilibrit të drejtë përfshin pyetjen nëse rrethanat e posaçme të rastit janë marrë mjaftueshëm parasysh nga shteti, duke përfshirë çështjen nëse masat e kontrollit të “pronës” ose një pjese të pronës, ndikuan në vlerën ose përfitimin e pjesës që nuk mbulohet nga masat që i përkasin parashtruesit të kërkesës (shih rastet e GJEDNJ-së, Azas kundër Greqisë, nr. 50824, Aktgjykim i 21 majit 2002, paragrafët 51-53; Interoliva ABEE kundër Greqisë, nr. 58642/00, Aktgjykim i 10 tetorit 2003, paragrafët 31-33).
86. Vërej se në rastin konkret, kemi të bëjmë me masën e kontrollit të “pronës”, duke pasur parasysh se parashtruesit të kërkesës i është pezulluar leja ujore dhe ajo mjedisore, por nuk ka pasur konfiskim të pronës, siç është ndërtimi në hidrocentral dhe pajisjet në to, si dhe hapësira e punës së parashtruesit të kërkesës.
87. Prandaj, konsideroj se pavarësisht faktit se nuk ka pasur konfiskim të pronës, por vetëm një masë kontrolli të “pronës”, me vendimin për pezullimin e lejes ujore dhe mjedisore për një periudhë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës pësoi një zvogëlim të vlerës së pjesëve të pronës që nuk ishte përfshirë me masat, për shkak se të njëjtat e humbën funksionin bazë që kishin sa ekzistonte licenca.

d) Aspekte të ndërlidhura me parashtruesin e kërkesës

88. Një nga faktorët më të rëndësishëm për testin e ekuilibrit sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 është të shihet nëse parashtruesi i kërkesës është përpjekur që të shfrytëzojë ndonjë dobësi apo boshllëk në sistemin juridik (shih rastet National & Provincial Building Society, Leeds Permanent Building Society dhe Yorkshire Building Society kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 117/1996/736/933-935, Aktgjykim i 23 tetorit 1997, paragrafi 109). Ngjashëm, në rastin *G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 301, Gjykata ka theksuar se shkalla e fajësisë apo neglizhencës së parashtruesit të kërkesës ose, së paku, marrëdhënia ndërmjet sjelljes së tyre dhe shkeljes në fjalë, mund të merret parasysh me qëllim të vlerësimit nëse revokimi ishte i arsyeshëm.
89. Përkitazi me këtë faktor, nuk ka asnjë informatë as nga autoritetet shtetërore kompetente dhe as nga gjykatat e rregullta se parashtruesi i kërkesës ka shkelur ndonjë normë, është dënuar ose është përpjekur të përfitojë nga ndonjë mangësi apo zbrazëti në rendin juridik (shih rastin e GJEDNJ-së, OGIS-Institut Stanislas, OGEC Saint-Pie X dhe

Blanche de Castille dhe të tjerë kundër Francës, nr. 42219/98 et 54563/00, Aktgjykim i 27 tetorit 2004, paragrafët 69 dhe 71).

90. Prandaj, konstatoj se parashtruesi i kërkesës nuk u përpoq të përfitojë nga ndonjë mangësi ose zbrazëti në rendin ligjor, se parashtruesi i kërkesës nuk u shpall fajtor ose neglizhues në shfrytëzimin e lejes në mënyrë të paligjshme, në mënyrë që Gjykata të mund të vlerësojë se ishte e nevojshme masa e kontrollit të përdorimit të pronës.

e) Kompensimi për ndërhyrje në pronësi si element i ekuilibrit të drejtë

91. Kushtet e kompensimit janë esenciale për vlerësimin e ekuilibrit të drejtë, dhe posaçërisht çështja nëse masa e kontestuar u imponon parashtruesve të kërkesës barrë të paarsyeshme (shih rastet e GJEDNJ-së, Manastiret e shenjta kundër Greqisë, nr. 13092/87 dhe 13984/88, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 71; Platakou kundër Greqisë, nr. 38460/97, Aktgjykim i 5 dhjetorit 2001, paragrafi 55). Marrja e pronës pa pagesën e një shume të arsyeshme në lidhje me vlerën e saj, zakonisht përbën ndërhyrje joproporcionale dhe mungesa e plotë e kompensimit mund të konsiderohet e justifikueshme në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1, vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.
92. Ajo që është e arsyeshme varet nga rrethanat e secilit rast, por një marginë e gjerë e vlerësimit është e mundshme gjatë vlerësimit të shumës së kompensimit. Autorizimi i Gjykatës për rishikim kufizohet në vlerësimin nëse përzgjedhja e kushteve të kompensimit bie jashtë marginës së vlerësimit të shtetit në këtë domen (shih rastin e GJEDNJ-së, James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, cituar më lart, paragrafi 54). Gjykata do të respektojë vlerësimin e pushtetit legjislativ lidhur me kompensimin për ndërhyrje në të drejtën për gëzimin paqësor të "pronës" përveç rasteve kur është qartazi pa bazë të arsyeshme (shih rastin e GJEDNJ-së, Lithgow dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 9006/80; 9262/81; 9263/81; 9265/81; 9266/81; 9313/81; 9405/81, Aktgjykim i 8 korrikut 1986, paragrafi 122).
93. Në rastin konkret, vërej se masat e kontrollit të pronës ndodhën pa asnjë kompensim për parashtruesin e kërkesës. Masat e kontrollit të pronës pa pagesën e një shume të arsyeshme në lidhje me vlerën e saj zakonisht do të përbëjnë ndërhyrje të paarsyeshme dhe një mungesë e plotë e kompensimit mund të konsiderohet e justifikuar në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.
94. Vërej se sipas sistemeve juridike të Shteteve Kontraktuese, marrja e pronës për interes publik pa pagesën e kompensimit trajtohet si e justifikuar vetëm në rrethana të jashtëzakonshme që nuk janë relevante për qëllimet aktuale. Për sa i përket nenit 1 (P1-1), mbrojtja e të drejtave pronësore që ai parashikon do të ishte në masë të madhe iluzore dhe joefektive në mungesë të ndonjë parimi ekuivalent (shih rastin e GJEDNJ-së, Lithgow dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, cituar më lart, paragrafi 122).
95. Prandaj, konkudoj se ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës së parashtruesit të kërkesës ka ndodhur pa pagesën e asnjë kompensimi parashtruesit të kërkesës, prandaj nuk është arritur një "ekuilibër i drejtë" ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit.

f) Përfundim lidhur me ekuilibrin e drejtë

96. Prandaj, unë si gjyqtar individual lidhur me faktorët që merren parasysh për të përcaktuar nëse ka pasur proporcionalitet në ndërhyrjen në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës së parashtruesit të kërkesës, konstatoj:

- a) se për sa i përket faktorëve proceduralë, parashtruesi i kërkesës kishte një mundësi të arsyeshme për t'i paraqitur argumentet e tij pranë gjykatave të rregullta. Megjithatë, gjatë procedurës së zhvilluar në gjykatat e rregullta, e posaçërisht në Gjykatën Supreme, ato nuk i kanë shqyrtuar me kujdes pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës;
 - b) se nuk kanë ekzistuar masa të tjera alternative, masa më pak ndërhyrëse që autoritetet publike do të mund t'i zbatonin në mënyrë të arsyeshme për realizimin e interesit publik. Konsideroj se i njëjti qëllim mund të ishte arritur nga një ndërhyrje më pak invazive në të drejtat e parashtruesit të kërkesës, si dhe se autoritetet nuk shqyrtuan mundësinë e zbatimit të atyre zgjidhjeve më pak ndërhyrëse;
 - c) se pavarësisht faktit se nuk ka pasur konfiskim të pronës, por vetëm një masë kontrolli të "pronës", me vendimin për pezullimin e lejes ujore dhe mjedisore për një afat të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës ka pësuar një zvogëlim të vlerës së pjesëve të pronës që nuk ishin përfshirë me masat, sepse të njëjtat e humbën funksionin bazë që kishin përderisa ekzistonte licenca;
 - d) se parashtruesi i kërkesës nuk është përpjekur të përfitojë nga asnjë mangësi apo zbrazëti në rendin ligjor, se parashtruesi i kërkesës nuk është shpallur fajtor apo neglizhues në përdorimin e paligjshëm të lejes ujore dhe mjedisore, në mënyrë që gjykata të vlerësojë se masa e kontrollit të përdorimit të pronës ishte e nevojshme;
 - e) se ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës së parashtruesit të kërkesës ka ndodhur pa paguar asnjë kompensim për parashtruesin e kërkesës, prandaj nuk është arritur një "ekuilibër i drejtë" ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit.
97. E rikujtoj rastin e GJEDNJ-së, Megadat.Com SRL kundër Moldavisë, ku GJEDNJ kishte vlerësuar se masa e ndërmarrë nga autoritetet shtetërore ndaj kompanisë që ofronte shërbime të internetit, ishte aq e rëndë sa që kompania në fjalë ishte detyruar që ta mbyllte biznesin dhe të shiste të gjitha asetet e saj brenda një kohe shumë të shkurtër (shih rastin e GJEDNJ-së, Megadat.com SRL kundër Moldavisë, cituar më lart, paragrafi 69).
98. Në fund, vërej se vendimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të të paditurve dhe pezullimi i ekzekutimit të lejes ujore dhe mjedisore për një periudhë të pacaktuar ishte i menjëhershëm dhe nuk parashihte asnjë kompensim apo periudhë kalimtare që do t'i mundësonte parashtruesit të kërkesës të vazhdojë me ushtrimin e veprimtarisë së tij ekonomike.
99. Nga të gjitha sa më sipër, konkludoj se në dritën e rrethanave mbizotëruese të rastit dhe vlerësimeve të përshkruara më parë, ndërhyrja në gëzimin paqësor të pronës në rastin e parashtruesit të kërkesës nuk ishte proporcionale sepse ai kishte pritshmëri legjitime që gjatë periudhës për të cilën ai kishte leje pune të vlefshme, do të ishte në gjendje të ushtrojë veprimtarinë e tij ekonomike dhe të gëzojë në mënyrë të qetë pronën e tij.
100. Në fund, vlerësoj se Aktgjykimi [ARJ. UZVP. nr. 51/2022] i Gjykatës Supreme i 19 korrikut 2022 në lidhje me Aktvendimin [AA. nr. 386/2022] e Gjykatës së Apelit të 26 majit 2022 dhe Aktvendimin [A. nr. 3129/2021] e Gjykatës Themelore të 12 prillit 2022, që ndërlidhjen me pezullimin e Lejes Ujore dhe Lejes Mjedisore për një periudhë të pacaktuar: (i) përbën ndërhyrje në gëzimin paqësor të pronës së parashtruesit të kërkesës, si rezultat i ndërprerjes së aktivitetit të tij biznesor: (ii) se ndërhyrja ka qenë e

bazuar në ligj; (iii) se masa e kontrollit ka ndjekur një qëllim legjitim; (iv) megjithatë ndërhyrja nuk ishte proporcionale, sepse të njëjtit si rezultat i pezullimit të Lejes Ujore dhe Lejes Mjedisore për një periudhë të pacaktuar i është ndërprerë ushtrimi i aktivitetit biznesor, i cili rezulton në humbje të fitimit dhe rrezikun potencial që i njëjti aktivitet të pushojë së ekzistuari.

101. Prandaj, Gjykata konstaton se Aktgjykimi [ARJ. UZVP. nr. 51/2022] i Gjykatës Supreme i 19 korrikut 2022 në lidhje me Aktvendimin [AA. nr. 386/2022] e Gjykatës së Apelit të 26 majit 2022 dhe Aktvendimin [A. nr. 3129/2021] e Gjykatës Themelore të 12 prillit 2022, janë nxjerrë në shkelje të së drejtës së gëzimit paqësor të pronës së parashtruesit të kërkesës, e drejtë kjo e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

(VI) Përfundim në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesit të kërkesës

102. Bazuar në sa më sipër, dhe duke marrë parasysh shqyrtimet e pretendimeve të parashtruesit në kërkesën e tij:

- I. PAJTOHEM se janë të bazuara pretendimet e parashtruesit se përmes Aktgjykimit [ARJ. UZVP. nr. 51/2022] të Gjykatës Supreme të 19 korrikut 2022 në lidhje me Aktvendimin [AA. nr. 386/2022] e Gjykatës së Apelit të 26 majit 2022 dhe Aktvendimin [A. nr. 3129/2021] e Gjykatës Themelore të 12 prillit 2022, i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, siç arsyetohet në Aktgjykim.
- II. KONSIDEROJ se janë të bazuara pretendimet e parashtruesit se përmes Aktgjykimit [ARJ. UZVP. nr. 51/2022] të Gjykatës Supreme të 19 korrikut 2022 në lidhje me Aktvendimin [AA. nr. 386/2022] e Gjykatës së Apelit të 26 majit 2022 dhe Aktvendimin [A. nr. 3129/2021] e Gjykatës Themelore të 12 prillit 2022, përmes të cilëve është nxjerrë vendimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të të paditurve dhe pezullimin e ekzekutimit të lejes ujore dhe asaj mjedisore për një periudhë të pacaktuar, është shkelur e drejta e parashtruesit për gëzim paqësor të pronës, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Mendimi konkurrues është paraqitur nga gjyqtari:

Radomir Laban, gjyqtar

Më 20 dhjetor 2022, në Prishtinë.

